



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE

Nr. 1945₃ Prot.

Shkodër, më 19.06. 2018

PLAN - MASASH

Për menaxhimin sa më efikas të sezonit turistik lidhur me administrimin e zhurmave në mjedis.

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr. 139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”, Ligjit nr 9774/2007 “ Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis”, nenit 22,23 të Ligjit nr 10431/2011 “ Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar , VKM nr 123 datë 17.02.2011 “ Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis” si edhe Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr 1 datë 19.02.2018 “ Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat”.


QELLIMI : Menaxhimi i qëndrueshëm i zhurmës me qëllim respektimin e niveleve të lejuara dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.

Objektivat:

- Objektivi kryesor është menaxhimi i qëndrueshëm i zhurmave me qëllim respektimin e niveleve të lejuara dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.
- Marrjen e masave për përmirësimin e administrimit të zhurmës në mjedis, kryesisht për burimet e zhurmës që vijnë nga ambientet tregëtare, ambiente zbavitëse (klube nate, bare, restorante disko etj) .
- Në çdo rast të ndërmeren hapat ligjore për ndëshkimin e shkelësve sipas parashikimeve në aktet normative, administrative dhe ligjore.

INFORMIMI DHE MONITORIMI I SITUATËS

Për përmirësimin e situatës mbi zhurmat në mjedis , masat e nevojshme që duhen marrë për përmirësimin e situatës së monitorimit dhe menaxhimit gjatë të sezonit turistik sin ë zonën turistike Velipojë ashtu edhe në qytetin e Shkodrës.



PLANI I MASAVE

Për menaxhimin sa më efikas të sezonit turistik lidhur me administrimin e zhurmave në mjedis.

Nr.	Masat	Periudha	Institucioni përgjegjës	Institucioni bashkëpunues	Referenca ligjore
1.	Vendosja e sinjalstikes rrugore për kufizimin dhe ndalimin e zhurmave nga automjetet, pranë zonave të qeta.	Deri më 15.07.2018	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave Bashkia Shkodër	Policia vendore Shkodër	Ligji Nr. 139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”.
2.	Identifikimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari muzikore (burime zhurmash).	Deri më 20/06/2018	Bashkia Shkodër Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave,	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Shkodër	Ligji nr 9774/2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
3.	Subjektet që ushtrojnë aktivitet që gjeneron zhurmë në mjedis (disko , klub nate, bar me muzikë etj) , duhet të jetë i pajisur me <u>Leje Mjedisore Tip C</u> dhe <u>Leje nga Bashkia Shkodër për orarin e ushtrimit të këtyj</u>	Maj-Shtator 2018 (Gjatë gjithë sezonit turistik)	Bashkia Shkodër, Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të		Ligji Nr. 139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”.

	aktiviteti.		Ujërave, Drejtoria Rajonale e Mjedisit Shkodër	Pika 3 VKM nr 587/2010 "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike" Pika 14 neni 3 i Ligjit 10448/2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar
4.	Monitorimi i orarit të përcaktuar sipas VKM nr 587/2010 dhe lejes së dhënë nga bashkia Shkodër. Orari i zhvillimit të aktivitetit është : Për mjediset e hapura, orari i lejit të veprimtarive për ditët e premtë dhe të shtunë të jetë nga ora 19:00 deri në orën 24:00, ndërsa për ditët e tjera të javës të jetë nga ora 19:00 deri në orën 23:30.	Maj-Shtator 2018 (Gjatë gjithë sezonit turistik)	Strukturat e policisë vendore Shkodër Policia Bashkiake	Pika 4, VKM nr 587/2010 "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike" Pika 7 neni 8 I Ligjit nr 8224/1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë bashkiake" I ndryshuar, VKB nr 84 dt 26.12.2017 "Për miratimin e paketës fiskale" kap III.3 Tab 38 ipka 3.5,3.8.
5.	Kontrolli i matjes së zhurmës, monitorimit të këtyre matjeve dhe vërtetësisë së rezultateve të Raporteve të vetmonitorimit për subjektet me Leje Mjedisit tip C.	Maj-Shtator 2018 (Gjatë gjithë sezonit turistik)	Instituti Shtetëror Shëndetësor - Drejtoria Shkodër Drejtoria	Ligji Nr. 139/2015, "Për Vetqeverisjen Vendore", Pika 5 neni 8, Neni

6.	<p>Për aktivitete të cilët zhvillohen nga Bashkia Shkodër ose partneritet me Bashkinë Shkodër , Institucione , NGO etj , aktivitete të zhvilluara në ambiente të mbyllura ose të hapura si sheshe/rrugë publike etj , miratimi i orarit të zhvillimit të tyre do të bëhet rast mbas rasti sipas vlerësimit që do të bëhet edhe me drejtoritë përkatëse të Bashkisë Shkodër.</p>	Maj-Shtator 2018 (Gjatë gjithë sezonit turistik)	Bashkia Shkodër Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.	Policia Bashkiake Strukturat e policisë vendore Shkodër	29,30 i Ligjit 9774/2007 “ Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” Ligji nr 8224 dt.15.05.1997 ”Për policine Bashkiake e të Komunës” I ndryshuar” Neni 17 i Ligjit 9774/2007 “ Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
7.	<p><u>Ushtrimi pa Leje Mjedisit tip C i veprimtarive që lëshojnë zhurmë në mjedis dhe në shkelje të kushteve të matjes përbën shkelje ligjore .</u></p>		Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve Ujrave dhe Turizmit – Drejtoria Rajonale Shkodër Strukturat e policisë vendore Shkodër Policia Bashkiake		Pika 1 neni 32 i Ligjit 9774/2007 “ Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” neni 29 i Ligjit 10448/2011 “ Për lejet e mjedisit”i ndryshuar Pika 5 e VKM nr 587/2010 “ Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”

